



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 547/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohet programi i studimit i BPrAL Akademia “Evolucion”:

- Arte Mediale, BA. 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Akademia “Evolucion” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programit të studimit: Arte Mediale, BA. 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Arte Mediale, BA. 180 ECTS	BA	180	Valter Lucaj, Shpresa Mulliqi, dhe Faton Bytyqi

AKA ka organizuar vizitën në Akademinë “Evolucion” më 26.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Doris Carstensen dhe Bettina Henkel.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Akademisë “Evolucion”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qarë në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, programi i studimit karakterizohet nga Akademia Evolucion si program akademik, artistik dhe profesional i cili i mundëson studentëve të fitojnë praktikë artistike dhe akademike dhe të fokusohen në praktikat profesionale duke përdor teknikat e produksionit të filmit dhe TV-së. Sipas ekspertëve, ky program është shumë më shumë i orientuar në gazetari, komunikim dhe produksion në kontekstin e televizionit, medias digjitale, portaleve online dhe filmit. Sipas diskutimeve që ekspertët kanë pasur në Akademinë Evolucion është kuptuar që programi është “Video Editim dhe Gazetari e TV-së” dhe ky është titulli i brendshëm i programit.

Sipas ekspertëve një program i studimit në arte mediale karakterizohet nga produksioni i artit bashkëkohor dhe kryesisht bazohet në artin konceptual. Këto dy elemente janë të marginalizuara në programin e studimit aktual. Artet e bukura, dhe artet mediale si pjesë e artit bashkëkohor nuk janë pjesë përbërëse e kurrikulës as në aspektin teorik dhe as atë praktik.

Përfundimisht sipas ekspertëve programi i studimit Arte Mediale nuk është program i artit. Për shkak të mos përputhjeve në mes të programit të studimit “Arte Mediale” dhe qëllimit të programit, objektivave dhe përmbajtjeve të lëndëve të programit i cili sipas ekspertëve është program studimi në TV/ Produksion Filmi me fokus të fuqishëm në gazetari televizive, ekspertët nuk kanë rekomanduar ri akreditimin e programit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Akademia “Evolucion”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë